



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2012

LËNDA: QYTETARI

VARIANTI **A**

E shtunë, 30 qershor 2012

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Duke analizuar ligjin, përshkruani: **3 pikë**
- a) vlerën politike të tij _____
- b) ligjin organik _____
- c) ligjin civil _____
2. Shpjegoni parimet e mëposhtme të Kushtetutës së Shqipërisë: **3 pikë**
- a) shteti i së drejtës _____
- b) zgjedhjet _____
- c) pluralizmi _____
3. Në një ministri diskutohet një projekt i madh që ka të bëjë me integrimin e Shqipërisë në BE. Një anëtar i Gjykatës Kushtetuese takon kryetarin e grupit të projektit dhe i kërkon të marrë në grup një njeriun e tij. Kjo ndërhyrje cënon parimin e Kushtetutës për: **1 pikë**
- A) ndarjen e pushteteve
- B) kushtetueshmërinë
- C) pluralizmin
- D) sovranitetin
4. Në një familje ndodhi një fatkeqësi: nëna e dy fëmijëve të vegjël vdiq nga një sëmundje e pashërueshme. Babai i tyre u ndje shumë keq. Më parë kishte pësuar një divorc. Në kushtet e vështira për të rritur fëmijët, ai u martua me një grua tjetër. Si edhe më parë, autoriteti i tij nuk diskutohej në shtëpi....Duke studiuar situatën, gjeni: **2 pikë**
- a) për ç'loj martese flitet _____
- b) llojin e familjes(nisur nga fjalët e nënvizuara) _____
5. Gjyshërit e një familjeje kujdeseshin për fëmijët e vegjël 3 dhe 5 vjeç dhe po i llastonin shumë. Prindërit e fëmijëve e kishin merak këtë dukuri dhe përpiqeshin t'i disiplinonin ata kur ishin në shtëpi. Kjo zemëronte gjyshërit. Pas disa debatesh ata vendosën që fëmijët të shkonin në kopësht. Vërtet ndikimi ishte i shpejtë dhe i dukshëm. Me cilin funksion të familjes lidhet më shumë shqetësimi i prindërve për fëmijët: **1 pikë**
- A) riprodhues
- B) ekonomik
- C) socializues
- D) emocionues
6. Roli i mësuesit në shkollë: **1 pikë**
- A) fillon kur bie zilja e orës së parë dhe mbaron kur mbyllet ora e fundit
- B) fillon para se të nisë zyrtarisht rënia e ziles për mësim dhe mbyllet kur janë larguar të gjithë nxënësit
- C) lidhet me një shpjegim sa më të kujdesshëm të mësimin dhe vlerësimit sa më objektiv të nxënësit
- D) ka të bëjë me gjithë procesin mësimor edukativ të nxënësit në shumë përmasa
7. Kodi i Punës i RSH parashikon se të miturit mund të punojnë: **1 pikë**
- A) 16 vjeç, punë të lehta gjatë pushimeve shkollore
- B) 15 vjeç, çdo lloj pune, në çdo kohë
- C) 13 vjeç, punë të përhershme, me natyrë të ndryshme
- D) 13 vjeç, punë të lehta, gjatë pushimeve shkollore

8. Përshkruani ligjin shqiptar për fëmijët lidhur me: **3 pikë**
- a) përgjegjësinë penale _____
- b) kundravajtjen penale _____
- c) arsimimin e detyrueshëm të tyre _____
9. Shpjegoni: **3 pikë**
- a) vlerësimin që adoleshentët bëjnë për marrëdhëniet me bashkëmoshatarët në raport me prindët

- b) një ndryshim fizik të adoleshentëve _____
- c) një ndryshim psikologjik të adoleshentëve _____
10. Në Kodin shqiptar të Punës, neni 9/1, thotë se ndalohej çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe profesionit. Kjo do të thotë se: **1 pikë**
- A) vendasit do të punësohen më parë se pakicat kombëtare
- B) emigrantët duhet të trajtohen me përparësi sipas marrëveshjeve ndërkombëtare
- C) të moshuarit duhen trajtuar në mënyrë të veçantë
- D) nuk duhen dallime për moshën, racën gjininë etj.
11. Listoni tre rreziqe me të cilët përballet planeti ynë sot: **3 pikë**
- a) _____

- b) _____

- c) _____

12. Të ushqehesh do të thotë: **1 pikë**
- A) për një të moshuar - të konsumosh sasi të mëdha ushqimi dhe të ndihesh i ngopur fiziologjikisht
- B) për një gjimnazist - të hash të gjitha vaktet ushqimore, në mënyrë që të plotësosh dëshirat e tua të nevojshme për t'u kënaqur
- C) të jesh përzgjedhës, të konsumosh ushqime të pasura me vlera ushqimore të nevojshme për funksionimin normal të organizmit
- D) të mos jesh përzgjedhës për sasinë dhe cilësinë e ushqimeve që konsumon
13. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë me konceptin “shëndet” kuptojmë: **1 pikë**
- A) një gjendje të mirëqenies fizike
- B) një gjendje të mirëqenies mendore
- C) një gjendje të mirëqenies shoqërore
- D) të gjitha alternativat

14. Përshkruani tre ndikime negative të përdorimit të drogës.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

15. Konsumator është ai që:

1 pikë

- A) merr një dhuratë
- B) blen produkte për qëllime tregtare
- C) blen produkte nga një individ që nuk është biznes
- D) blen produkte për përdorim personal, jo për t'i shitur e përpunuar

16. Përshkruani tre funksione të reklamës, përveç reduktimit të kostos së shitjes:

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

17. Përshkruani tre lloje të sinjaleve rrugore, të klasifikuara sipas formës, ngjyrës dhe mesazhit që transmetojnë:

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

18. Përparësia në qarkullimin rrugor i jepet:

1 pikë

- A) automjetit që vjen nga e majta
- B) automjetit që vjen nga e djathta
- C) mjeteve të tonazhit të rëndë
- D) mjeteve me të cilët qarkullojnë fëmijë dhe të moshuar

19. Me termin informacion në media kuptohen:

1 pikë

- A) faktet me interes publik që i përcillen publikut në formën e lajmit
- B) çdo gjë që ndodh përreth njerëzve, me dhe pa interes për ta
- C) dukuri që janë të njohura më parë, por disa njerëzve u duken interesante
- D) dukuri të reja të çfarëdoshme

20. Për secilën media të përmendur, përshkruani:

4 pikë

- a) një përparësi të radios _____
- b) një mangësi të shtypit _____
- c) një përparësi të internetit _____
- d) një mangësi të internetit _____